



Urdhëresa Nr. 01/01 "Për zbatimin e masave ndaj veprimtarive ekonomike lidhur me emergjencën e shëndetit publik", (tani e tutje: Urdhëresa Nr.01/01), e datës 17.03.2020

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike ("**Ministria**"), me qëllim të zbatimit të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të ndërmarra lidhur me parandalimin e Corona Virus COVID – 19, ka nxjerrë Urdhëresën Nr.01/01 e cila ju drejtohet zbatimit të masave ndaj operatorëve dhe veprimtarive ekonomike lidhur me emergjencën e shëndetit publik.

Ministria ka urdhëruar operatorët ekonomik zbatimin e këtyre kushteve:

- 1. Zbatimin e vendimeve të Qeverisë së Kosovës Nr. 01/09 "Për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID – 19", datë 13 Mars 2020 dhe Vendimin Nr. 01/11 "Për Shpalljen e Emergjencës për shëndetin publik", datë 15 Mars 2020.**
- 2. Operatorët ekonomik duhet të marrë këto masa higjienike parandaluese:**
 - Të dezinfektoje dhe ajrosë rregullisht lokalin dhe hapësirën e punës;
 - Të sigurohet pajisja e punëtorëve me mjete mbrojtëse, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë;
 - Të sigurohet se personat brenda lokalit të qëndrojnë në largësi prej 1 metra nga njëri tjetri;
 - Të sigurojë që lokali nuk është i stërmbushur aq sa njerëzit brenda të mos mund të rrinë larg njëri-tjetrit të paktën për një metër;
 - Të sigurojnë që blerësit të rrinë me radhë ose rrinë jashtë lokalit deri t'ju vije radha për të blerë;
 - Të siguroj se brenda lokalit nuk ka persona të tjerë përveç punëtorëve dhe blerësve;
 - Kanalet elektronike të shfrytëzohen me aq mundësi sa ka, duke përfshirë këtu edhe shitjen e mallrave ose ofrimin e shërbimeve, aq sa është e mundshme; dje
 - Të sigurohet se puna është duke u organizuar në ndërrime, për të zvogëluar numrin e punëtorëve të pranishëm në punë, aq sa është e mundshme;
- 3. Mbylljen e restoranteve, kafiterive, baret, pabet, qendrat tregtare (duke përjashtuar farmacitë bujqësore dhe shitoret ushqimore brenda qendrave tregtare), tregjet e kafshëve dhe tregjet e automjeteve. Shtëpitë e mallrave, tregjet e mbyllura dhe lokalet e ngjashme do të konsiderohen si qendra tregtare.**



4. Operatorët me aktivitete shitje-shërbim mund të vazhdojnë të shesin, por nuk mund të shërbejnë brenda lokalit ose në hapësira të punës. Operatorët e tillë definohen:
 - Furrat e bukës, bukatorët, qebaptoret, ëmbëltoret, gjellëtoret dhe ushqimoret tjera, që shërbejnë ushqim dhe shërbejnë brenda lokalit; dhe
 - Autolarjet dhe pikat e karburantit, që shesin mallra dhe shërbimet për automjete, por dhe kafiteritë ose restorantet brenda lokalit.
5. Ndalohet konsumi i pijeve dhe ushqimit brenda mensës së punëtorëve. Por punëtorëve mund tu ofrohet pije dhe ushqim jashtë mensës.
6. Ndalohen operacionet e gastronomisë (restorantet dhe bufetë) në hotele. Mysafiret mund të shërbehen ushqimi dhe pijet në dhomë. Hoteli duhet të sigurojë që ka të dhënat e sakta të mysafirëve, duke përfshirë shtetin prej nga kanë ardhur. Hoteli duhet të ndërmarrë masa në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë.
7. Operatorët e posaçëm që merren me shërbime komunale, financiare, elektronike dhe postare mund të ofrojnë shërbime deri në një masë të domosdoshme, por me orar të shkurtuar dhe staf të reduktuar.
8. Kjo urdhëresë mbetet në fuqi deri në shfuqizimin e emergjencës shëndetësore me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky dokument behet vetëm për qëllime informative. Nuk përbën këshillë ligjore dhe / ose angazhim të cdo lloji natyre. Për çdo sqarim ju lutem kontaktoni:

tax_legal-alko@deloittece.com